



DOGANA E KOSOVËS

2024

Raport vjetor 2024 për zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale nga Dogana e Kosovës



**SEKTORI PËR TË DREJTAT E PRONËSISË INTELLEKTUALE
DREJTORIA E ZBATIMIT TE LIGJIT**

12/31/2024




1. Përmbledhje ekzekutive

Sektori për të drejtat e pronësisë intelektuale (SDPI-së) duke ju referuar Planit Strategjik të DK-së, ka hartuar planin e veprimit dhe Procedurat Standarde të Operimit (PSO). Si rezultat i arritjes së objektivave të planit të veprimit, janë shënuar rezultate të kënaqshme në regjistrimin aplikimeve të reja dhe në luftimin e falsifikimit të mallrave që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale. Ngritja dhe fuqizimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me komunitetin e biznesit ka dhënë rezultate në parandalimin dhe luftimin e falsifikimit dhe piraterisë.

Përmbledhja e statistikave të ndalesës së mallrave nën dyshimin se shkelet e drejta e pronësisë intelektuale në tri vitet e fundit.

Ndalesat e mallrave në tri vitet e fundit	2022	2023	2024
Numri i rasteve	612	672	805
Sasia e mallrave	968980 cp	3,334,374 cp	17211013cp
Vlera e mallrave	~10,690,249.00€	16,636,893.00 €	23,500,726.00 €






Gjatë vitit 2024, DK ka marrë masa doganore nën dyshimin se shkelet e drejta e pronësisë intelektuale në 805 raste prej të cilave:

1. **312 raste-Konfiskim të** mallit në sasi prej 272226 cp dhe vlerë prej € 13 mil;

Grafikoni I më poshtë pasqyrën statusin e mallrave të ndalura për verifikim të origjinalitetit.






Mallrat e falsifikuara apo pirate, kryesisht janë asgjësuar sipas procedurës së thjeshtëzuar, pra pas konfirmimit të bartësit të së drejtës dhe marrëveshjen e pronarit të mallrave.

Në përputhje me nenin 23 të ligjit 06/L-015/2018 dhe UA 053/2018, procedura e asgjësimit është kryer nën mbikëqyrjen doganore, nën përgjegjësin dhe me shpenzimet e bartësit të së drejtës.

Grafikoni I më poshtë pasqyrën vlerën e mallrave që I janë nënshtruar verifikimit te orgjinalitetit, konfiskimit dhe asgjësimit te mallrave te falsifikuara.







PERMBAJTJA

Përmbledhja ekzekutive.....	2-5
Përmbajtja.....	6
Hyrja.....	7
Përshkrimi i Përgjithshëm.....	8
Kërkesat për veprim dhe bashkëpunimi me bartësit e së drejtës.....	9
Statistikat e raportimit të rasteve.....	10
Kategoria e mallrave të ndaluar.....	11
Origjina e mallrave.....	12
Shkeljet e markave tregtare dhe dizajneve industriale.....	13
Vetëdijesimi dhe ndërgjegjësimi i publikut.....	14
Problemet dhe sfidat.....	14



2. Hyrje

Raporti vjetor synon të pasqyroj përkushtimin e Doganës së Kosovës në parandalimin dhe luftimin e falsifikimit dhe piraterisë, si dhe në veçanti punën e Sektorit të DPI-së përgjatë vitit 2024. Raporti përmban të dhëna statistikore në përgjithësi për veprimet doganore në lidhje me shkeljet e pronësisë intelektuale. Rezultatet e paraqitura në raportin vjetor mbi masat doganore për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, janë mundësi e mirë për të matur shkallën e veprimeve doganore për zbatimin DPI-së. Parandalimi dhe luftimi i falsifikimit dhe piraterisë janë një ndër prioritetet e Doganës së Kosovës (DK). DK është e përkushtuar në përmbushjen e obligimeve që dalin nga MSA-ja, ku fillimisht ka harmonizuar legjislacionin primar dhe sekondar në fushën e DPI-së me *acquis* të BE-së, si dhe përmes zbatimit të drejtë të ligjit DK do të siguroj nivel të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale konform praktikave të BE-së..

DK që nga viti 2017 është bërë anëtare e Organizatës Botërore të Doganave (OBD), ku pjesëmarrja në këtë Organizatë I ka dhënë mundësi Doganës së Kosovës të jetë bashkë-pjesëmarrëse në operacione ndërkombëtare për luftimin e tregtisë së jashtëligjshme në përgjithësi. Andaj, edhe në luftimin e falsifikimit dhe piraterisë, Dogana e Kosovës vazhdimisht merr pjesë në operacione botërore të organizuar nga OBD për luftimin e falsifikimit dhe piraterisë.

Dogana e Kosovës si anëtare e Këshillit Shtetëror për Pronësi Intelektuale dhe anëtare e TASK FORCËS kundër piraterisë, brenda mandatit të saj është përkushtuar në vazhdimësi që të jep imputin në përmbushjen e objektivave të Planit të Veprimit. Gjithashtu, Dogana si anëtare e Task Forcës merr pjesë në takimet e rregullta të kësaj trupe, ku gjatë vitit 2024 ka marrë pjesë në 12 takime. DK ka dhënë një kontribut të veçantë në hartimin e Ligjit për të drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, si dhe fushën e vetëdijesimit dhe ngritjes së kapaciteteve, në bashkëpunim me institucionet ligj zbatuese janë organizuar trajnime për stafin doganor për pronësinë intelektuale dhe pjesëmarrje aktive në aktivitete të ndryshme ndërgjegjësuese. Me qëllim të luftimit të dukurive negative për mallrat që shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale dhe si të tilla shiten në tregun e Kosovës, duke dëmtuar rënd ekonomin dhe shëndetin publik, anëtarët e Task Forcës, konkretisht organet ekzekutive (Dogana e Kosovës, Policia e Kosovës/DEK dhe DKKO dhe Inspektorati i Tregut, sipas planit Operativ “Kontrolli i tregut të brendshëm/mallra të falsifikuara dhe pirate” kanë organizuar operacionet tek 11 subjekte në 3 regjione të Kosovës, ky operacion është udhëhequr nga Dogana e Kosovës. Kjo nismë vije si rezultat i bashkëpunimit ndër-institucional dhe përkushtimit të Task Forcës për të luftuar efektivisht falsifikimin dhe piraterinë. Operacioni kishte rezultuar i suksesshëm, me inicimin e 45 rasteve për verifikim të origjinalitetit dhe sekuestrimin e mallit në sasi prej 3094cp dhe vlerë prej mbi 300000 Euro.



3. Përshkrim i përgjithshëm

3.1 Roli Doganës ne mbrojtjen e te drejtës se pronësisë intelektuale:

Dogana luan një rol shumë të rëndësishëm në identifikimin dhe ndaljen në kufi të mallrave që dyshohet se shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale. E gjithë kjo ne te njëjtën kohe paraqet sfide për Doganën e Kosovës, pasi qe një nder detyrat kryesore është; mbrojtja e ambientit të biznesit të cilët janë mbajtës dhe/ose përdorues të një të drejte të pronësisë intelektuale, nga konkurrenca e pandershme; mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit publik nga mallra të falsifikuara/piratë; kufizimet e mundshme të humbjeve të të ardhurave në buxhetin e shtetit tone, që vinë si pasojë e mallrave që cenojnë një të drejtë të pronësisë intelektuale. Dogana e Kosovës ka kompetenca të veproj ndaj mallrave që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale në gjitha procedurat të parapara me Kodin Doganor dhe të Akcizave (import, eksport, ri-eksport, transit, përpunim i brendshëm, procedurën e magazinimit etj).

Vlen të theksohet se, që nga hyrja në fuqi të Ligjit të ri 06/l-L-0152018 dhe UA 053/2018, DK është e përkushtuar të ketë nivel të zbatimit të masave doganore për mbrojtjen e pronësisë intelektuale të ngjashëm me Doganat e vendeve të BE-së. Për të forcuar zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale, ndërhyrja e doganave me Ligjin aktual shtrihet edhe në llojet e tjera të shkeljeve që nuk kanë qenë të mbuluara më parë, ku përveç të drejtave që kanë qentë tashmë të mbuluara me Ligjin e ri janë përfshirë edhe të drejtat për: emrat tregtare, topografit e produkteve gjysmëpërçues dhe modelet e përdorimit.

Në rastet kur dyshohet se cenohet e drejta e pronësisë intelektuale, autoritetet doganore kanë kompetenca të; reagojnë nëpërmjet kërkesës për veprim të bartësit të të drejtave, reagojnë edhe ex officio, ndërmarrin ndalimin e mallrave, zbatojnë masa të përkohshme në rastet kur zotëruesi i të drejtës mund të vërtetojë shkeljen e të drejtave të PI-së, shkatërrojë mallrat pirate dhe të falsifikuara.


Duke e marrë për bazë se inovacioni dhe kreativiteti janë motorët kryesor të zhvillimit të ekonomisë, është e rëndësishme që shteti të siguroj mbrojtje për bartësit e të drejtave, për të ngritur nivelin e ekonomisë së ligjshme.



4. Kërkesat për veprim doganor dhe bashkëpunimi me bartësit e së drejtës.

Bazuar në dispozitat ligjore të Ligji 06/L-015/2018 dhe Udhëzimit Administrativ 053/2018, Sektori I DPI-së edhe gjatë vitit 2024 ka ndërmarr veprime, të cilat kanë rezultuar me rezultate të kënaqshme. Vlen të theksohet se njëra ndër rezultatet e kënaqshme është edhe ngritja dhe forcimi I bashkëpunimit me agjencionet përkatëse të zbatimit të ligjit dhe komunitetin e biznesit, kjo vërehet përmes aplikimeve ne Doganën e Kosovës, ku nga viti ne vit është shtuar numri i kërkesave për aplikim për veprim Doganor, e qe tani dogana numëron gjithsej 148 aplikacione për 601 marka tregtare, 40 vepra të drejta të autorit dhe 1 Treguesi Gjeografik “Shampanjë”, 6 dizajne industriale.

Statistikat mbi numrin e kërkesave për veprim doganor gjatë vitit 2024






5. Statistikat e raportimit të rasteve

Sektorin e DPI-së në bashkëpunim të ngushtë me Zyrat e Brendshme Doganore, Pike Kalimet Kufitare, Sektorin e Riskut, Sektorin e Inteligjencës dhe Sektorin e Anti-kontrabandës Qendrore, gjatë vitit 2024 ka shënuar rezultate të kënaqshme në parandalimin dhe luftimin e piraterisë dhe falsifikimit. Krijimi i profileve të riskut për DPI-në dhe komunikimi i tyre tek Zyrat Doganore e DPI-së, ka ndikuar pozitivisht në targetimin elektronik të subjekteve të dyshimta për shkelje të DPI-së. Kodet e veçanta tarifore, vlera dhe origjina e mallrave janë tregues për t'u krijuar profilet e riskut. Po ashtu, burim për krijimin e profileve të riskut janë edhe informatat e siguruar nga bartësit e të drejtave, ku gjatë aplikimit, bartësit e të drejtave japin informata për subjektet e dyshimta, prodhuesit e produkteve të falsifikuara, si dhe karakteristikat e mallrave të falsifikuara për identifikimin sa më të lehtë nga DK, kështu që kërkesa për veprim merr një rol të rëndësishëm dhe të thellë edhe në menaxhimin e riskut. Bazuar në statistika për periudhën 2024, grafikoni i mëposhtëm paraqet gjendjen e pasqyruar sipas raportimeve të rasteve nga Degët Doganore/Sektorët, për mallrat e dyshuara që shkelin pronësinë intelektuale, pra numri i rasteve të raportuara sipas markave tregtare.


Grafikoni i mëposhtëm pasqyron të dhënat e iniciuesve të rasteve sipas numrit të markave tregtare.



6. Kategoria e mallrave të ndaluar:

Gjatë vitit 2024, DK ka marrë masa doganore nën dyshimin se shkelet e drejta e pronësisë intelektuale në 805 raste për mallrat në sasi prej 17211013cp dhe vlerë mbi €23 mil. Kategoria kryesore e konfiskimit të mallrave të falsifikuara sipas sasisë janë: tekstil 41.1%, Aksesor për femra 19.6%, pajisje për matjen e sheqerit në gjak 19.1, Kozmetikë dhe preparate për mirëmbajtjen e lëkurës 6.8%, tiketa 4.7%, preparate për pastrim 3.4%, atlete 2.7% etj, ndërsa detajet tjera janë shfaqur në grafikonin e mëposhtëm.


Garfikoni i mëposhtëm pasqyron sasinë e mallrave falce të konfiskuara, sipas kategorisë gjatë vitit 2024.






7. Origjina/prejardhja e mallrave

Vendi i origjinës në parim është vendi ku janë prodhuar mallrat apo vend burim prej të cilave edhe janë importuar për në Kosovë. Sipas statistikave të mallrave të falsifikuara, gjatë kësaj periudhe janë konfiskuar mallrat e falsifikuara kryesisht në procedurën e importit dhe mallrat e zbuluara gjatë kontrabandës e nuk kanë pasur mbulesë me dokumentacion dhe si rezultat nuk kemi informata për origjinën e këtyre mallrave. Me një përqindje më të lartë janë mallrat që vinë nga Turqia me 55%, Kosova 25.6%, Kina me 8.5%, Shqipëria me 4.1%, Serbia me 3.1%, Maqedonia e Veriut 1.7%, Vietnam 1% etj (detajet tjera janë shfaqur ne grafikun).



8. Statistikat e shkeljeve të markave tregtare gjatë vitit 2024

Dogana e Kosovës është e përkushtuar edhe në parandalimin dhe luftimin e dukurive negative që vinë si pasojë e hyrje daljes së mallrave të falsifikuara dhe pirate. Referuar statistikave gjatë vitit 2024, DK ka konfiskuar mallrat të falsifikuara në sasi prej 272226 cp dhe vlerë prej € 13 mil, ku sipas sasisë së mallit të falsifikuar, numri më i madhe i shkeljeve të markave tregtare është paraqitur si në grafikonin e mëposhtëm.





9. Ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve gjatë vitit 2024

Ditën Botërore të Pronësisë Intelektuale e datës 26 Prill, është shënuar edhe në Kosovë nga Institucionet që luajnë rol në promovim dhe mbrojtje të drejtave të pronësisë intelektuale. Për shënimin e kësaj dite janë realizuar shumë aktivitetet ndërgjegjësuëse, duke përfshi konferenca me gjitha institucionet e Kosovës dhe komunitetin e biznesit. Gjithashtu, në kuadër të organizimit janë realizuar aktivitete të ndryshme promovuese në disa Universite të Kosovës, ku qëllimi i aktivitetit ishte ndërgjegjësimi i gjeneratave të reja për rolin dhe rendësin që ka pronësia intelektuale në Kosovë. Gjithashtu mesazhe ndërgjegjësuëse janë përcjell edhe përmes platformave digjitale dhe programeve televizive.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në fushën e DPI-së, Sektori për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale në bashkëpunim me Sektorin e Trajnimeve, periodikisht organizojnë trajnime për zyrtaret doganor në fushën e DPI-së".

Gjithashtu, DK është duke e dhen kontributin në vetëdijësimin të publikut edhe përmes publikimit të artikujve në revistën "AUTORI".

Aktivitete e Sektorit të DPI-së gjatë vitit 2024.

10. Problemet dhe Sfidat

Dogana e Kosovës mbetet e përkushtuar për të adresuar sfidat e procesit integruës gjithnjë duke pasur referencë kryesore efikasitetin në misionin dhe përgjegjësinë që ka për mbrojtjen e qytetarëve nga hyrjet e paligjshme të mallrave të falsifikuara.

Pavarësisht progreseve të arritura që nga hyrja në fuqi i ligjit për masat Doganore për Mbrojtje të Pronësisë Intelektuale e deri më tani, Dogana e Kosovës ka shumë sfida përpara në luftimin e falsifikimit dhe piraterisë.

Ndër sfidat kryesore janë;

- ✓ Rritjen e nivelit të konkurrencës së ekonomisë së ligjshme,
- ✓ Zhvillimi i bashkëpunimit me agjencitë përkatëse të zbatimit të ligjit,
- ✓ Zhvillimi i partneritetit Doganë -Biznes në fushën e PI,
- ✓ Ngritja e vetëdijes së publikut për rolin dhe rendësin e mbrojtjes së pronësisë intelektuale,